

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM - së" nr. 5/02), nenit 7 të Ligjit për kulturë ("Gazeta zyrtare e RM - së" nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11 dhe 51/11) dhe nenit 10, pika 5 të Ligjit për Qytetin e Shkupit (55/04, 158/11), Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e njëzetetë, të mbajtur më 17.12.2018, solli këtë

## **PROGRAM**

### **për financimin e institucioneve publike dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2019**

#### **I. LËNDA E PROGRAMIT**

Lëndë të këtij Programi janë aktivitetet që do të realizohen gjatë vitit 2019, prej të cilave do të zbatohen kompetencat e Qytetit të Shkupit, në fushën e kulturës dhe do të definohet interesi lokal në kulturë.

Me këtë Program është përfshirë financimi dhe puna e institucioneve publike nga fusha e kulturës themelues i të cilave është Qyteti i Shkupit, si dhe realizimi i projekteve të cilat do të realizohen përmes personave të tjerë fizik dhe juridik nga fusha e kulturës të cilët veprojnë në territorin e Qytetit të Shkupit në fushën e kulturës, të cilët do të jenë të zgjedhur përmes thirrjes publike ose procedurës për furnizime publike.

Qyteti i Shkupit në kuadër të kompetencave të tij në fushën e kulturës në përputhje me Ligjin për kulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15 dhe 39/16 – Vendimi i Gjyqit kushtetues të RM-së, K.nr. 196/2007 të datës 16.01.2008 të shpallur në "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 15/2008), ligjet e veçanta nga fusha e kulturës (Ligjin për muzetë "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/04, 89/08, 116/10, 51/11, 88/15, 152/15 dhe 39/16) Ligjin për biblioteka ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 66/04, 89/08, 116/10, 51/2011, 88/15, 152/15 dhe 39/16), Ligjin për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02), Ligjin për institucione ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 32/05, 120/05 dhe 51/11), Ligjin për Qytetin e Shkupit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 55/04, 158/11) ka të drejtë të:

- Ofrojë përkrahje institucionale dhe financiare të institucioneve kulturore dhe projekteve me rëndësi për Qytetin e Shkupit;
- Realizojë ruajtjen e folklorit, traditave, zanateve të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore;
- Organizojë manifestime nga fusha e kulturës, nxit forma të ndryshme specifike të krijimtarisë dhe
- Shënojë ngjarje dhe personalitete me rëndësi për komunën.

#### **II. QËLLIMI I PROGRAMIT**

Qëllimi kryesor i Programit për financimin e aktiviteteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2019 është të definojë interesin lokal në kulturë përmes përkrahjes së formave të reja dhe bashkëkohore të veprimit në fushën e kulturës dhe artit, përkrahjen e vlerave të konfirmuara në kulturë dhe art, përkrahjen dhe nxitjen e formave të ndryshme të të shprehurit tradicional të banorëve të qytetit të

Shkupit, promovim të trashëgimisë kulturore, punën e institucioneve publike nën kompetencë të Qytetit të Shkupit dhe të tjera në kuadër të autorizimeve ligjore.

- Qyteti i Shkupit do ta realizojë interesin lokal në kulturë gjatë vitit 2019 edhe përmes sigurimit të përkrahjes institucionale dhe logjistike të aktiviteteve të cilat nxitin bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mes komunal në fushën e kulturës me subjekte të ndryshme ndërkombëtare dhe të vendit nga fusha e kulturës, vetëqeverisjet lokale, organet drejtuese kombëtare dhe organizata tjera të ngjashme,
- Qyteti i Shkupit gjithashtu mund ta realizojë interesin lokal në kulturë për vitin 2019 edhe përmes sigurimit të logjistikës dhe përkrahjes institucionale të projekteve dhe aktiviteteve të kryerësve të tjerë nga fusha e kulturës të cilët nuk janë financuar përmes Buxhetit të Qytetit të Shkupit për vitin 2019, nëse konfirmohet se janë me interes dhe rëndësi të veçantë për Qytetin e Shkupit;
- Mjediset në 8-të institucionet nga fusha e kulturës në pronësi të Qytetit të Shkupit, në terminët kur institucionet nuk e përdorin për realizimin e programeve të tyre, mund të huazohen për përdorim nga subjektet, programet dhe aktivitetet e të cilëve janë pjesë e këtij Programi, pas marrjes paraprake të mendimit nga Qyteti i Shkupit.

### **III. FINANCIMI**

Financimi i interesit lokal në kulturë bëhet nga Buxheti i Qytetit të Shkupit dhe nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë përmes Buxhetit të Qytetit të Shkupit edhe atë përmes bllok - dotacioneve të destinuara gjithsej 23,310,000 denarë, edhe atë gjithsej: Programi K1 – Veprimtari biblioteke – 4,035,825 denarë, K2 – Veprimtari muzikore – skenike – 10,236,991 denarë, K3 – Veprimtari muzeu dhe galerie – 9,037,184 denarë dhe nga Buxheti i Qytetit të Shkupit përmes: Programit K4 – Manifestime kulturore dhe krijimtari – 96,086,000 denarë, Programi K2 – 150,000 denarë, Programi KA0 - Manifestime kulturore dhe krijimtari (shpenzime kapitale) 37,230,000 denarë, Programi JO – 300,000 denarë dhe Programi JM – 1,800,000 denarë.

**Për realizimin e interesit lokal në kulturë nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2018 janë parashikuar gjithsej 158,876,000 denarë**

Financimi i interesit lokal në kulturë i Qytetit të Shkupit, si dhe realizimi i këtij programi do të zhvillohet përmes tre (3) segmenteve programore:

- A) Financimi i institucioneve publike nga fusha e kulturës,**
- B) Financimi i manifestimeve, projekteve dhe krijimtarisë përmes së cilit realizohet interesi lokal në kulturë,**
- C) Financimi i investimeve kapitale në kulturë.**

#### **A) Financimi i institucioneve publike nga fusha e kulturës**

Me programin për financimin e kulturës janë përfshirë financimi i tetë (8) institucioneve publike nga fusha e kulturës themelues i të cilave është Qyteti i Shkupit:

IP Qendra kulturore rinore, IP Kopshti zoologjik, IP “Salla universale”, IP Muzeu i qytetit të Shkupit, IP Biblioteka e qytetit “Vëllezërit Milladinov”, IP Shtëpia e kulturës “Koço Racin”, IP Qendra kulturore fëmijërore “Karposh” dhe IP Qendra informative kulturore.

Për realizimin e funksionit dhe veprimtarisë të institucioneve publike nga fusha e kulturës, përmes bllok-dotacioneve, në Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2019, të shpërndara në programet K1, K2 dhe K3 janë ndarë mjete në vlerë prej 23,310,000 denarë.

Me këto mjete financiare, do të bëhet mbulimi i shpenzimeve rrjedhëse – operative të institucioneve (ngrohje qendrore, rrymë, ujë, shpenzime për komunikim, transport dhe të tjera) dhe do të realizohen një pjesë e aktiviteteve të parashikuara programore për vitin 2019 edhe atë:

**1. IP Qendra kulturore rinore  
4,410,617 denarë - Programi K2**

Mbulimi i shpenzimeve rrjedhëse-operative dhe realizimi i një pjese të aktiviteteve programore në përputhje me planin financiar të dorëzuar nga ana e institucionit.

**2. IP Kopshti zoologjik,  
4,835,287 denarë - Programi K3**

Mbulimi i shpenzimeve rrjedhëse-operative dhe realizimi i një pjese të aktiviteteve programore në përputhje me planin financiar të dorëzuar nga ana e institucionit.

**3. IP “Salla universale”,  
1,118,933 denarë - Programi K2**

Mbulimi i shpenzimeve rrjedhëse-operative dhe realizimi i një pjese të aktiviteteve programore në përputhje me planin financiar të dorëzuar nga ana e institucionit.

**4. IP Muzeu i qytetit të Shkupit,  
3,401,897 denarë - Programi K3**

Mbulimi i shpenzimeve rrjedhëse-operative dhe realizimi i një pjese të aktiviteteve programore në përputhje me planin financiar të dorëzuar nga ana e institucionit.

**5. IP Biblioteka e qytetit “Vëllezërit Milladinov”,  
4,035,825 denarë - Programi K1**

Mbulimi i shpenzimeve rrjedhëse-operative dhe realizimi i një pjese të aktiviteteve programore në përputhje me planin financiar të dorëzuar nga ana e institucionit.

**6. IP Shtëpia e kulturës “Koço Racin”,  
1,494,138 denarë - Programi K2**

Mbulimi i shpenzimeve rrjedhëse-operative dhe realizimi i një pjese të aktiviteteve programore në përputhje me planin financiar të dorëzuar nga ana e institucionit.

**7. IP Qendra kulturore fëmijërore “Karposh”  
1,362,891 denarë - Programi K2**

Mbulimi i shpenzimeve rrjedhëse-operative dhe realizimi i një pjese të aktiviteteve programore në përputhje me planin financiar të dorëzuar nga ana e institucionit.

### **8. IP Qendra kulturore informative**

**1,850,412 denarë - Programi K2**

**800.000 denarë - Programi K3**

Mbulimi i shpenzimeve rrjedhëse-operative dhe realizimi i një pjese të aktiviteteve programore në përputhje me planin financiar të dorëzuar nga ana e institucionit.

<b>B) Financimi i manifestimeve, projekteve dhe krijimtarisë përmes të cilave realizohet interesi lokal në kulturë,</b>
---

Ky program financohet përmes Programit K4 – Manifestime kulturore dhe krijimtari, K2 - Veprimtari muzikore – skenike, me shumë të përgjithshme prej **96,236,000 denarë**.

Në këtë program bëjnë pjesë aktivitete, manifestime, krijimtari, festivale dhe projekte nga fusha e kulturës, si pjesë e aktiviteteve programore që do të realizohen nga ana e institucioneve nga fusha e kulturës, themelues i të cilëve është Qyteti i Shkupit, por edhe programe, realizimi i të cilëve do të jetë nën kompetencë të Seksionit për kulturë, Sektorin për veprimtari publike, dhe që do të realizohen nga ana e faktorëve të tjerë të zgjedhur përmes procedurës përkatëse, si vijon:

1. IP Qendra kulturore rinore	Teatër “Nga fëmijët për fëmijët” – Shfaqje teatrale “Magjistari nga Ozi”
	Puna dhe veprimtaria e Kinemasë së qytetit „Milenium”
	Projekte edukative për fëmijë dhe të rinj
	Mbajtja e ekspozitave të artistëve vizual
	„Teatri ri i hapur 2019”
	Festivali i filmit evropian „SINED@YS”
	Veprimtaria e orkestrës frymore të qytetit
	Puna dhe veprimtaria e Korit rinor të femrave
	Puna dhe veprimtaria e orkestrës së mandolinave
	Manifestimi „Përsëritje rini”
	Program letrar
	Klub debatues filmik “Tulipani”
	“Parku veror i qytetit”
	Koncerte vjetore në QKM së
	“Cërnilla” Remiks i turneut V-1
	Realizimi i projektit evropian „CREART“ „Art rrugor (stret art)“
	Për pagesën e aktiviteteve lidhur me pritjen e Vitit të Ri 2019
„Tingujt e çarshisë”	
Realizimi i Manifestimit multikulturor dhe multimedial „Të gjithë së bashku, për të gjithë më mirë”	
Organizimi i ekspozitave të arteve vizuale	

2. IP Qendra kulturore informative	„Dita e pianos”-festimi i ditës botërore të pianos
	Mbrëmje letrare „Shkupi lexon”
	Koncerte nga fusha e muzikës serioze „Vijmë”
	Gjimnaziada
	Rrjedha maqedonase letrare - promovioni i librave të rinj të krijuar
	Romani i vitit (Fondacioni Sllavko Janevski)
	Projekt për ruajtjen e muzikës së vjetër qytetare shqiptare - „Këngë të arta”
	Koncert për muzikë serioze
	Realizimi i projektit evropian „CREART”
3. IP Muzeu i Qytetit të Shkupit	Shënimi i “26 Korrikut”
	Shënimi i jubileut 70 vjeçar i Muzeut të Qytetit të Shkupit
	Kolonia ndërkombëtare e arteve figurative “Shkupi”
	Shënimi i “13 Nëntori” – Dita e çlirimit të Shkupit
	Organizimi i ekspozitave
	Financimi i projekteve nga fusha e veprimtarisë muzeore
	Vizita ndërkombëtare
	Mirëmbajtje fizike, rrjedhore dhe sezonale e lokalitetit arkeologjik
	Realizimi i projektit evropian „CREART” – Shënimi i ditës së EU – së të kreativitetit artistik
Po të flisnin ndërtesat: pavijoni maqedonas për kuadri - enales për dizajnin dhe hapësirën skenike – Pragë 2019	
4. IP “Salla universale”	„Festivali i dritës”
	„Nata e bardhë 2019”
	Festival i muzikës akustike
	Incizime, produksion dhe promovioni i filmit dokumentar i historisë së Sallës universale
	Shkup – Qyteti evropian i kulturës 2028
	Festivali i artit alternativ “Shkupi alternativ”
	Realizimi i projektit evropian „CREART”
	Ceremonitë e Korit të Shkupit
5. IP Qendra kulturore e fëmijëve “Karposh”	Apriliada
	Koret gazmore të fëmijëve
	„Valle pa kufi”
	„Rolerijada”
	Gara ndërkombëtare për kitarë klasike „Tremolo” 2019” – jubileu 10 vjet
	Kampionati i shahut për të rinjtë
	Punëtori për mentor kreativ
	Udhëtime në gara dhe turne
	Festivali ndërkombëtar për klarinetë dhe saksofon „SAKS KLAR 2019”

	Lëviz për shëndet
	Instrumentet e paraardhësve të mi
	Zhvillojmë dhe ndërtojmë talent të ri (punëtori)
	Projekt muzikor edukativ „ZOO Alfabeti“
	Sheshi gazmor
6. IP Shtëpia e kulturës “Koço Racin” - Shkup	“Ditët” Manifestim letrar kushtuar Koço Racin
	Festivali ndërkombëtar i folklorit „Luajmë dhe këndojmë së bashku“
	Ekspozita të artistëve virtual
	Ditë të alfabetit shqip
	Organizimi i takimeve multikulturore
	Aktivitete nga fusha e letërsisë
	Njëqind mijë poet dhe artistë për paqe dhe ndryshime
	Punëtori interaktiv për fëmijë dhe të rinj
	65 vjet jubileu i Shtëpisë së kulturës “Koço Racin”
	Shfaqje teatrale amatore “Dashuria e Talatit dhe Fitnetes”
	Festivali teatral nacional „ Njerëz pa maska 2019“
7. IP Biblioteka e qytetit “Vëllezërit Milladinov”	Furnizimi për fondin e librave
	Mbrojta e librave të vjetër të dëmtuar dhe të rralla nga fondi i IP Biblioteka e qytetit “Vëllezërit Milladinov”
	Konferenca ndërkombëtare e bibliotekistëve, novatorëve dhe kreatorëve
	Digjitalizimi i përmbledhjeve të librave vjetër dhe të rrallë nga fondi i Bibliotekës “Vëllezërit Milladinov”
	Aktivitete, manifestime dhe konkurse të literaturës etj
	Program ndërkombëtar
	“Vendlindja ime” në frymë të Naim Frashërit
8. Programe dhe projekte sipas thirrjes publike të shkruar për vitin 2019	
9. Mirëmbajta e hapësirave instaluese edukative fëmijërore në pronësi të Qytetit të Shkupit	
10. Projekt “Nga qendra kah periferia – Kultura si mjet për ndryshime shoqërore”	
11. Kompensime autoriale	
12. Pagesa e aktiviteteve programore për fundvit nga viti 2018	
13. Realizimi i projektit evropian „Kre-art“	
14. “ Shkupi kreativ “ Festivali i industrive kreative	
15. Strategji për zhvillimin e kulturës	
16. QKF „Karposh“ – Pagesa e shpenzimeve gjyqësore dhe të avokatëve	

### **C) Financimi i investimeve kapitale në fushën e kulturës**

Me këtë Program do të realizohen edhe investimet kapitale të Qytetit të Shkupit në lëmin e kulturës, aktivitete ndërtimore dhe të infrastrukturës dhe furnizimit të pajisjeve në institucionet publike nga fusha e kulturës, themelues i të cilave është Qyteti

i Shkupit, por edhe investimet kapitale në kulturë, realizimi i të cilave do të jetë nën kompetencë të Seksionit për kulturë të Sektorit për veprimtari publike, dhe do të realizohen nga ana e operatorëve ekonomik të zgjedhur përmes procedurës adekuate.

Shuma e përgjithshme e paraparë për këtë program është **39.330.000 denarë** në **Programi KA–Manifestime dhe krijimtari kulturore (Shpenzime kapitale)**, dhe **Programi JM dhe Programi JO** në të cilin bëjnë pjesë aktivitetet vijuese:

Nr.	Bartës	Emri dhe përshkrimi i projektit
1.		Konkurs për zgjedhjen e zgjidhjes ideore dhe realizimin e instalimeve edukative të fëmijëve
2.		Monumente përkujtimore
3.		Rekonstruksioni i „Guaska”
4.		Galeria e qytetit
5.	IP Biblioteka e qytetit “Vëllezërit Milladinov”	Mbikëqyrje video (video kamera)
6.	IP Biblioteka e qytetit “Vëllezërit Milladinov”	Furnizimi dhe sajimi me rafte për libra
7.	IP Biblioteka e qytetit “Vëllezërit Milladinov”	Rikonstruksioni i tualeteve
8.	IP Biblioteka e qytetit “Vëllezërit Milladinov”	Furnizimi me një ashensor ngarkues hidraulik për bibliotekën “Shoku”
9.	IP Biblioteka e qytetit “Vëllezërit Milladinov”	Rikonstruksioni në hapësirën e brendshme
10.	IP Muzeu i Qytetit të Shkupit	Adaptimi i pjesës së brendshme të objektit
11.	IP Muzeu i Qytetit të Shkupit	Shkupi 2014 – Qendra informative
12.	IP Muzeu i Qytetit të Shkupit	Punëtori ilegale për armë – e dyta
13.	IP Muzeu i Qytetit të Shkupit	Faza e dytë nga renovimi dhe modernizimi i të përhershëm i qëndrimit të muzeut në Muzeun e Çarshisë së Vjetër të Shkupit
14.	Shtëpia e kulturës “Koço Racin”	Rikonstruksion dhe adaptim të shtëpisë
15.	IP QKF „Karposh”	Furnizimi i mobilieve dhe pajisjeve teknike
16.	IP QKF „Karposh”	Furnizimi i pajisjeve dhe dyshemesë së baletit
17.	IP QKF „Karposh”	Biblioteka rrugore
18.	IP QKF „Karposh”	Furnizimi i ashensorit (platforma për karroca invalidore për shkallët e jashtme dhe karrige invalidore për shkallët e brendshme).
19.	IP Qendra kulturore informative	Furnizimi i paneleve ekspozuese dhe i tramit për veprat artistike për nevojat e QIK
20.	IP Qendra kulturore informative	Korniza montuese për vepra artistike
21.	IP“Kopshti zoologjik”	Vendosja e tabelave informuese në kopsht
22.	IP“Kopshti zoologjik”	Riinstalimi i tërësishëm i sistemit të monitorimit në kopsht

23. IP“Kopshti zoologjik”	Ndërtimi i vend panoramës në kopshtin e botanikës
24. IP“Kopshti zoologjik”	Aktivitete të ndërlidhura me Dinopark
25. IP Qendra kulturore rinore“	Renovimi i plato-së para QKM - së
26. IP Qendra kulturore rinore“	Skenë verore (Skenë e mbyllur montuese)
27. IP “Salla universale”	Blerje e pajisjeve për zyre
28. IP “Salla universale”	Blerje e pajisjeve informatike dhe video
29. IP “Salla universale”	Blerje e pajisjeve për nxehje dhe klimatizim

#### **IV. Dispozita përfundimtare**

Kryetari i Qytetit të Shkupit kujdeset dhe e siguron realizimin e këtij Programi.

Spektori për veprimtari publike – Seksioni për kulturë e përgatit këtë Program dhe përcjell realizimin tij.

Komisioni për kulturë i Këshillit të Qytetit të Shkupit ofron iniciativa dhe jep mendime në lidhje me këtë Program

Për përcaktimin e programit vjetor dhe për mjetet financiare për realizimin e tij, Qyteti i Shkupit dhe bartësit e projekteve – shfrytëzuesit e mjeteve të Buxhetit të Qytetit të Shkupit për vitin 2019 lidhin kontrata.

Ky Program hyn në fuqi një ditë pas ditës së shpalljes në “Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” .